



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
STRUKTURA PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

Nr. 02 prot

Pukë, më 07.04.2022

PROJEKT-VENDIM
NR. 02, Date 07, 04, 2022

Per dhenien e dakortesise per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik per 0.02 ha per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW nga shoqeria "AML GROUP" Sh.p.k

Bazuar ne Ligjin nr. 139 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore". Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ne Ligjin nr.10304, date 15.07.2010 "Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise", ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullosor publik...", ne VKM nr. 591, date 9.10.2018, "Per disa ndryshime ne VKM nr 1353, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe paraqitjen e kerkeses, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogelimit te siperfaqes dhe te vellimit te fondit pyjor", ne VKM nr. 592, date 09.10.2018 "Per disa ndryshime ne VKM nr. 1374, date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhen dryshimin e destinacionit te fondit kullosor" Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkeseve per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik", nga ana Struktures Pergjegjese per pyjet dhe Kullotat .Me propozim te Kryetarit te Bashkise Keshilli Bashkiak pas shqyrtimit


VENDOSI:

1. Te shprehe dakortesine per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor/ kullosor publik per ndertimin e imjantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW te siperfaqes prej 0.02 Ha, ne ngastren 20 ne ekonomine "Gomsiqe" te Bashkise Puke
2. Siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor jane percaktuar ne raportin mbi studimin tekniko-ekonomik per dhenje/heqje nga fondi pyjor per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike
3. Per vazhdimin e procedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr 2/2016 te Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet Struktura Pergjegjese Per pyjet dhe Kullotat ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore,

4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Struktura Pergjegjese Per pyjet dhe Kullotat, zyra kadastres pjore
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6,e ligjit nr 139/2015"Per veteqeverisjen vendore"

HARTUESI

Ing Astrit Hyseni



JURISTI

Aida Sinani



KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
STRUKTURA PERGJEGJESE PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 8027/prot

Pukë, më 07.04.2022

RELACION

PER MIRATIMIN ME SHKRIM PER VIJIMIN E PROCEDURAVE TE HEQJES NGA
FONDI PYJOR PUBLIK TE NJE SIPERFAQE PREJ 0.02 HA NGA ANA
MINISTRISE TURIZMIT DHE MJEDISIT PER NDERTIMIN CENTRALIT
ELEKTRIK EOLIK NGA SHOQERIA "AML" Sh.p.k

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullosore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullosor eshte ligji nr 57/2020 si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te neneve 15 dhe 17 te ketij ligji ka dale udhezimi I Ministrise Mjedisit nr 01 date 09.06.2016"Per caktimin e kritereve per dhenje/heqje ne perdorim te fondit pyjore.

Bazuar ne udhezimin e mesiperm dhe ne kerkesen e bere nga ana shoqerise " AML" Sh.p.k drejtuar Bashkise Puke Date 09.06.2021 Per marrje ne perdorim dhe heqjen nga fondi pyjor te siperfaqes pyjore qe preken nga ndertimi e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike dhe veprave ndihmese pas marrjes se miratimit paraprak per vashdimin e procedurave nr 959/2 date 27.05.2021 afati I vleshmerise 24 muaj nga ana Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise në të dhënat e rregjistrimit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 20 „bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosor "Gomsiqe" dhe eshte në pronësi/administrim të te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 ne baze te kerkeses drejtuar Bashkise Puke me shkresen date 09.06.2021 ku kerkohet pergatitje e raportit

tekniko-ekonomik te vleresimit financiar per ndertimin impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike. Pas marrjes se kerkese nga ana Bashkise Puke eshte ngritur grupi I punes perbere nga dy injjineret pyjeve dhe eshte shkuar ne terren dhe eshte percaktuar qarte gjurma ne te cilen do te ndertohet impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike ne bashkine Puke dhe eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik I vleresimit financiar ku dhe jane percaktuar siperfaqet pyjore qe do te jepen ne perdorim dhe siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor kullisor dhe volume I materialit drusore qe do te demtohet nga punimet turbine eolike eshte nje aerogenerator (turbine ere) me fuqi prej 2MW..

Duke u bazuar ne V.K.M nr 591 date 09.10.2018 per disa ndryshime per vendimin nr 1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave "Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses mbajtjes dhe plotesimit e dekumentacionit teknik,si dhe te kritereve e procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjore" te ndryshuar pika ç kerkohet miratimi me shkrim per vashtimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak Brenda territorit administrative te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor nga ana Ministries Turizmit dhe Mjedisit


Ne menyre te permbledhur per heqjen nga fondi pyjore jane keto siperfaqe pyjore ne keto ekonomi pyjore ne territorin e Bashkise Puke

- Ekonomia Pyjore "Gomsiqe" parcela nr 20 siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.02 ha ku do te ndertohet bazamenti I shtylles eolike

Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e project vendimit per vijimin procedurave nga ana Ministrise Turizmit dhe Mjedisit ku kerkohet miratimi me shkrim nga ana keshillit Bashkiak per vijimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor ne baze baze te V.K.M 591 date 09.10.2018

Struktura Pergjegjese e Pyjet dhe Kullotave

Ing. Astrit Hyseni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË DHE
EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 959/3 Prot.

Tiranë më 31/05/2021

Lënda: *Njoftim*

SHOQËRISË "A.M - L GROUP" SH.P.K


Adresa: Autostrada Tr. - Dr. Km. 6, Katund i Ri, Komuna Kashar, Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 20.11.2020 "Aplikim për ndërtimin e një centrali elektrik eolik", protokolluar në MIE me Nr. 8216 Prot., datë 24.11.2020, dhe shkresës me datë 22.01.2021 "Plotësim dokumentacioni", protokolluar në MIE me Nr. 959 Prot., datë 22.01.2021, përmes së cilës kërkohet pajisja me miratim paraprak për vazhdimin e procedurave për ndërtimin e një impianti eolik me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Kçirës, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, ju vëmë në dijeni se:

Bashkëlidhur gjeni Miratimin Paraprak Nr. 959/2 Prot., datë 31/05/2021
"Për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë elektrike eolike, me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën e Kçirës, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, nga Shoqëria "A.M - L GROUP" Sh.p.k".

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Viola Haxhiademi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 43 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, i jepet:



SHOQËRISË "A.M - L GROUP" SH.P.K. MIRATIM PARAPRAK

(PËR VAZHDIM PROCEDURE)

Nr. 959/2, datë 31 . 05 . 2021

"Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike , me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Kçirës, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.

MINISTRI


BELINDA BALLUKU


Afati i vlefshmërisë: 24 muaj

Shoqëria "A.M - L Group" Sh.p.k.

Adresa: Autostrada Tr. - Dr. Km. 6, Katund i Ri, Komuna Kashar, Tiranë
Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT/NUIS: **K81427062S**

Objekti: E drejta ekskluzive e Shoqërisë "A.M - L Group" Sh.p.k, për të bërë matje dhe studime të tjera të nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm sipas nenit 20 të V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, për pajisjen me dokumentacionin përkatës për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Kçirës, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.

Shoqëria "A.M - L Group" Sh.p.k, në zbatim të nenit 20 të V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, për procedimin e mëtejshëm për pajisjen me autorizimet dhe lejet përkatëse, duhet që brenda 24 muajve, të përfundojë dhe dorëzojë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentacionin si më poshtë vijon:

- a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar, mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit;
- b) planin e biznesit të projektit;
- c) grafikun e zbatimit të projektit;
- d) miratimin e OST-së ose OSSH-së për përkën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes;
- e) lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
- d) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi truallin që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues.